

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
01	05.02.2026	Unë, Sh.Sh, banues në Këlcyrë, fshat Këlcyrë, ju drejtohem me këtë kërkesë për të marrë informacion zyrtar mbi ekzistencën ose jo të dokumentacionit pronësor të lidhur me pronën e familjes sime, dokumentacion i cili mund të jetë administruar historikisht nga strukturat pyjore ose nga institucionet pararendëse të tyre. Babai im i ndjere P. Sh ka blerë një pronë me kontratë shit-blerje nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP Përmet) në vitin 1996, Etero-Vajore Përmet. Për këtë pronë unë disponoj dokumentin kontratë shit-blerje por ka disa mangësi nga ana e qartësisë vizuale. Pas një kërkesë drejtuar Arkivit Qendror të Shtetit, më është kthyer përgjigje zyrtare, me të cilën konfirmohet se në fondet e tyre nuk është gjetur asnjë dokument që lidhet me pronësinë e pretenduar, madje sqarojnë se në Arkivin Shtetëror Vendor Gjirokastrë, nuk kanë të regjistruar dokumentacion të Degës së Agjencisë Kombëtare të Privatizimit Përmet si dhe të ndërmarrjes Etero-Vajore Përmet.	06.02.2026	Agjencia Kombëtare e Pyjeve e krijuar në vitin 2019 nuk disponon aktet e kërkuara të pronësisë së pretenduar të familjes së tij, pasi nuk ka trashëguar dokumentacion arkivor nga Ministria e Mjedisit dhe as nga ish-Drejtoritë e Shërbimit Pyjor në varësi të ministrisë, ku me shkrirjen e D.SH.P dhe ndryshimet ligjore e territoriale ku pyjet dhe kullotat i'u kaluan në pronësi bashkive, kërkuesi të interesohet në Kadastrën e pyjeve të strukturës së pyjeve dhe kullotave të bashkisë Përmet.	E plotë	0

		Duke qenë se një pjesë e dokumenteve të administrimit të tokave pyjore, kullotave dhe fondit pyjor shtetëror mund të jetë depozituar ndër vite pranë sektorit pyjor dhe institucioneve pararendëse të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, kërkoj që të verifikoni në arkivin tuaj nëse ekziston ndonjë dokumentacion pronësor, teknik, administrativ apo regjistrim arkivor që lidhet me pronën në fjalë, përfshirë çdo akt të mundshëm që ka të bëjë me përdorimin, administrimin, regjistrimin ose kategorizimin e saj si tokë pyjore apo kullotë. Nëse pas verifikimit del se në arkivat e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve ekziston dokumentacion i tillë, kërkoj që të më vihet në dispozicion kopja zyrtare e tij. Në rast se nuk rezulton asnjë dokument, kërkoj që kjo të më komunikohet me përgjigje zyrtare të arsyetuar, duke saktësuar njëkohësisht nëse ndonjë nga strukturat pyjore të mëparshme ka pasur detyrimin ligjor për depozitimin e dokumentacionit të këtij lloji.				
--	--	--	--	--	--	--